



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Opstinska Kancelarija za Zajednice i Povratak
Municipality Office for Communities and Returns



Nr.02/2/ 14

Datë: 03.03.2026

THIRRJE PUBLIKE

PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTET E OJQ-ve QË JANË NË INTERES TË KOMUNITETEVE JOSHUMICË.

Në bazë të nenit 12 të Rregullorës MFPT Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), e Komunës së Shtimes, u bën thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që i kontribuojnë komuniteteve joshumicë.
2. OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:
3. Të gjitha OJQ-të, në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e mbështetjes së arsimimit dhe edukimit të fëmijëve dhe të të rriturve të komuniteteve.
4. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt që i kontribuon vetëdijësimin të prindërve lidhur me arsimimin e komuniteteve ashkali dhe rom, në komunën e Shtimes..
5. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt që i kontribuon aktiviteteve kulturore rinore e që mund t'i realizojnë për shënimin e datave të veçanta, për komunitetet.
6. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: 4000 €
7. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë nga data e publikimit të Thirrjes Publike
8. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti 2 projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në dhjetor të vitit 2026. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes publike.

KRITERET PËR APLIKIM

1. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunen e Shtimes, së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
2. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e interesave të komuniteteve ashkali dhe rom duke u bazuar në objektivat e **Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikaën e Kosovës 2022-2026**.
3. OJQ-të duhet, po ashtu, të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.
4. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqen zyrtare të Komunës së Shtimes. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën:
Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës (Objekti i Komunës-Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ZKKK).
5. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
6. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
7. Përparësi kanë OJQ-të e komuniteteve që implementojnë aktivitete në Komunën e Shtimes.
8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në Zyren Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK-Shtime).

Dokumentet që OJQ-të duhet dorëzuar me rastin e aplikimit:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative)
2. Certifikatën e numrit fiskal (Obligative)
3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve-Obligative).
4. Projektpropozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (Obligative)
5. Propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (Obligative)
6. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera (Obligative)
7. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme (nëse kanë pasur)
8. Deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
9. Një CV të menaxherit të projektit.

Muhamet Mehmeti-

Zyrtar për të Drejta dhe Integritet të Komuniteteve në ZKKK

